
**KONTRATË
PËR
SHITJE KUOTASH**

Sot më datë **09/07/2018**, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe të statutit të shoqërisë "AURA" , nënshkruhet kjo "kontrate për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese

- **Eralda Kapidanja**, shtetase shqiptar, i identifikuar nga pasaporta (ose karta e identitetit) me nr. J15227071L, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 50 % të kuotave, të shoqërisë "AURA" , me NIPT L71928007N, *nga këtu e më poshtë referuar si "Shitësi"*,

dhe

- **Egnajt Kondakçiu**, shtetas shqiptar, i identifikuar nga pasaporta (ose karta e identitetit) me nr. J00813070J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 50 % të kuotave, të shoqërisë "AURA" , me NIPT L71928007N, *nga këtu e më poshtë referuar si "Blerësi"*.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitja prej Shitësit kundrejt Blerësit të **50 % (pesëdhjetë përqind)** të kuotave ose **1 (një) pjesë**, që Shitësi zotëron në shoqërinë "AURA" .

Neni 3

Çmimi i shitjes.

Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është **50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë**.

Neni 4

Mënyra e pagesës

Çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likuiduar prej blerësit, përpara nënshkrimit të kontratës.

Neni 5

Detyrimet e shitësit

Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave objekt të kësaj kontrate, që ai kishte në shoqërinë "AURA", kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.

Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

Neni 6


Detyrimet e Blerësit

Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Neni 7

Gjuha e Kontratës


Kjo kontratë përgatitet në 4 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.



Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi sot më datë **09/07/2018**.

SHITËSI

Eranda Kapidaj


BLERËSI

SONAJT KONDARCO
